


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2020

Tiranë, më 17 Gusht 2020: Në Korrik 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u ulur me 11,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 6,2 %, në krahasim me Qershor 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 56 mld lekë, duke u ulur me 5,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me Qershor 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 32 mld lekë, duke u ulur me 0,3 %, krahasuar me Korrik 2019 dhe duke u rritur me 9,9 %, në krahasim me Qershor 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në shtatëmujorin e 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 150 mld lekë, duke u ulur me 16,8 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 328 mld lekë, duke u ulur me 13,2 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 178 mld lekë, duke u ulur me 9,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 11,6 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -6,6 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,8 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0,1 pikë përqindje.

Për publikim 17/08/2020

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2020 (%)




Eksportet, gjatë këtij shtatëmujori janë ulur me 16,8 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar kryesisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -8,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,1 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 5,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,2 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me -1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,2 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik 2020 (%)



Si shtatëmujor, importet janë ulur me 13,2 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2019. Grupet që kanë ndikuar kryesisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -2,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,2 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Korrik 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2019 janë: Çekia (14,7 %), Serbia (42,5 %), dhe Rumania (12,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (16,9 %), Kosova (13,4 %) dhe Spanja (7,3 %).

Gjatë këtij shtatëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Gjermania (10,1 %), Serbia (8,1 %), dhe Franca (29,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (23,4 %), Kosova (25,5 %) dhe Spanja (10,8 %).

Në muajin Korrik 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2019 janë: Turqia (23,1 %), Kina (3,3 %) dhe Maqedonia Veriut (29,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (7,6 %), Greqia (5,1 %) dhe Gjermania (3,6 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Rusia (37,4 %), Maqedonia e Veriut (0,4 %) dhe Holanda (8,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (18,1 %), Turqia (2,2 %) dhe Greqia (9,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2020 në (%)



Shënim: Bashkimi Evropian (BE) përfshin 27 Vendet Anëtare. Mbretëria e Bashkuar u largua nga Bashkimi Evropian në 31 Janar 2020.

Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 64,3 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,1 %), Turqia (7,6 %), Greqia (7,5 %) dhe Kina (7,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmujorin e 2020, me vendet e BE zënë 63,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,4 %), Greqia (7,8 %), Gjermania (7,2 %) dhe Turqia (6,7 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626		-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	Janar – Korrik 18	185	16,8	368	5,0	-183	50,3
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	Janar - Korrik 19	180	-2,6	377	2,6	-197	47,7
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,6	56	-5,6	-32	43,5
	Janar –Korrik 20	150	-16,8	328	-13,2	-178	45,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2019	Korrik 2020	Jan. - Korr. 2019	Jan. - Korr. 2020	Korrik 2019	Korrik 2020	Jan. - Korr. 2019	Jan. - Korr. 2020
Vendet e BE-së	21.309	18.517	137.584	113.191	35.153	33.566	222.148	189.424
Austri	112	65	1.148	832	551	596	4.013	2.985
Gjermani	1.327	1.182	8.571	9.437	4.093	3.946	25.767	25.010
Greqi	1.305	1.232	7.747	6.936	5.088	4.830	33.368	30.086
Itali	14.165	11.769	89.888	68.867	16.266	15.026	98.938	81.039
Spanjë	1.676	1.554	11.205	9.992	1.058	887	6.803	5.209
Kroaci	85	86	685	1.017	652	901	4.023	3.735
Të tjera të BE-së	2.639	2.628	18.340	16.111	7.445	7.381	49.236	41.360
Mbretëri e Bashkuar	48	26	422	453	520	451	3.164	2.856
Kinë	599	373	3.684	2.962	5.223	5.397	34.686	28.537
Kosovë	3.040	2.631	17.424	12.974	741	859	4.439	4.422
Maqedonia e Veriut	716	678	4.918	4.565	696	903	4.966	4.989
Rusi	4	-	74	6	846	827	6.400	8.796
SHBA	253	179	2.176	1.636	822	676	6.085	4.970
Turqi	235	225	1.216	1.325	4.790	5.897	31.599	30.916
Ukrainë	2	19	111	289	270	155	1.740	2.534
Zvicër	104	45	514	461	928	886	9.139	6.173
Të tjera	1.444	1.847	11.979	12.054	9.769	6.818	53.064	44.157
Gjithsej	27.754	24.539	180.102	149.916	59.758	56.435	377.432	327.773

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2019	Korrik 2020	Jan. - Korr. 2019	Jan. - Korr. 2020	Korrik 2019	Korrik 2020	Jan. - Korr. 2019	Jan. - Korr. 2020
Gjithsej	27.754	24.539	180.102	149.916	59.758	56.435	377.432	327.773
Ushqime, pije, duhan	3.158	3.390	20.716	21.887	10.306	9.589	62.620	63.533
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.499	3.513	28.180	21.985	6.684	4.175	46.084	29.012
Produkte kimike dhe plastike	736	659	4.332	4.018	8.233	8.191	50.536	50.128
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	227	180	1.574	1.229	1.430	1.192	10.878	7.262
Prodhime druri dhe letre	862	749	5.583	4.692	2.548	2.110	14.650	12.924
Tekstile dhe këpucë	11.668	9.842	73.930	58.107	7.989	7.379	51.893	40.012
Materiale ndërtimi dhe metale	4.217	3.855	28.461	21.242	7.855	7.543	48.148	44.492
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	1.524	1.549	11.914	12.177	12.498	13.829	78.720	68.198
Të tjera	863	802	5.412	4.579	2.216	2.427	13.903	12.210

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	89.888	68.867	17.424	12.974	11.205	9.992	8.571	9.437
Ushqim, pije duhan	4.777	5.041	2.255	2.306	810	687	886	914
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.785	729	4.081	2.046	8.828	8.567	709	548
Produkte kimike dhe plastike	1.206	1.113	1.215	1.187	29	73	42	33
Lëkurë dhe artikujt prej lëkure	1.298	1.052	4	3	144	71	8	16
Prodhime druri dhe letre	3.814	2.776	473	442	3	2	94	257
Tekstile dhe këpucë	57.871	43.213	50	66	1.241	474	4.550	5.400
Materiale ndërtimi dhe metale	8.692	6.953	7.898	5.554	143	89	923	707
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.120	6.080	435	429	5	10	868	1.114
Të tjera	2.327	1.911	1.011	941	2	19	493	449

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Turqi		Greqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	98.938	81.039	31.599	30.916	33.368	30.086	34.686	28.537
Ushqim. pije duhan	11.212	11.165	3.260	3.198	9.137	9.399	471	398
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	4.875	2.628	460	1.659	7.948	5.470	3	4
Produkte kimike dhe plastike	10.945	10.618	4.477	4.840	4.579	4.476	3.205	3.146
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.735	5.926	140	129	20	19	446	289
Prodhime druri dhe letre	4.001	3.322	1.947	1.649	1.978	1.960	598	440
Tekstile dhe këpucë	25.096	18.317	10.103	8.128	2.213	2.054	6.602	4.952
Materiale ndërtimi dhe metale	11.641	9.645	6.086	5.964	4.905	4.208	5.794	3.798
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	19.274	16.771	3.889	4.314	1.689	1.688	14.330	12.626
Të tjera	3.160	2.646	1.237	1.037	900	812	3.238	2.884

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(±) deri